

DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS

Proçesi i Aplikimit për Shkollën e Mesme

Këshilla për Prindërit

Për Prindërit/Kuidestarët e nxënësve të klasave të 6^{-ta}, 7^{-ta}, dhe të 8^{-ta}

- Flisni me fëmijën tuaj për të njohur më mirë **interesat dhe dhuntitë** e tyre. Sëbashku, mendoni mbi planet për fëmijën tuaj në të ardhmen. Kontaktoni këshilltarin psikolog të shkollës për të mësuar se çfarë arsimimi dhe/ose trainimi është kërkesë në degën që ata kanë interes më shumë.
- **Kontrolloni rregullisht frekuentimin, notat dhe sjelljen** e fëmijës suaj. Këto janë kritere të rëndësishme të proçesit të aplikimit për në shkollat e mesme që Pranojnë me Kriter (*Special Admission*) dhe ato me Pranim të Gjërë (*Citywide-kryesisht janë shkolla të mesme teknike profesionale*).
- Kur fëmija juaj mungon në shkollë, dërgojini mësuesit një **shënim për mungesën** e bërë, ku shpjegoni **arsyen e mungesës**, në mënyrë që mungesa të quhet e **justifikuar**. Të dhënat e frekuentimit të fëmijës suaj kanë rëndësi kur ju të aplikoni në shkollat e mesme magnet, kolegje, apo në ato profesionale.
- Nëse jeni të preokupuar lidhur me **sjelljen** e fëmijës suaj në shkollë, kontaktoni shkollën për të diskutuar mbi mundësinë e mbështetjes që mund të merrni në këtë drejtim.
- Nëse jeni të preokupuar lidhur me **notat e deftesës** së fëmijës suaj, kontaktoni shkollën për të diskutuar mbështetjen dhe shërbimet që fëmija juaj merr në Programin Mësimor. Nxënësit me aftësi të kufizuara duhet të vlerësohen sipas dispozitave të Programit Individual Mësimor (IEP^{-të}) të tyre.
- Nëse doni të njiheni mbi **rezultatet e provimit të standardizuar** të fëmijës suaj, pyesni mbi rolin që kanë rezultatet në këtë provim, në lidhje me aplikimin tuaj për në shkollën e mesme. Kjo është pjesë edhe e debatit, nëse fëmija juaj duhet të testohet një nivel më poshtë në provimin e Terra Novas.
- Inkurajoni fëmijët tuaj të marrin pjesë në programet e komunitetit dhe ato mbas shkolle, të cilat janë projektuar **të zhvillojnë interesat dhe dhuntitë e fëmijës**. Kontaktoni këshilltarin psikolog të shkollës për informacion shtesë. Gjithashtu, pyesni se si mund të jepni ndihmën tuaj në shtëpi, në mënyrë që, fëmija juaj të përparojë në këto fusha.
- Rishikoni **Udhëzuesin e Shkollave të Mesme**. Flisni rreth programeve që janë në interes të fëmijës suaj. Bëni një listë të shkollave që do të donit t'i vizitonit gjatë Panairit të shkollave të mesme. Udhëzuesin e shkollave të mesme mund ta gjeni në shkollën e fëmijës suaj dhe në faqen e internetit me adresën: <http://www.phila.k12.pa.us/offices/sem/main.html>
- Ndiqni **Panairin e Shkollës së Mesme**. Vizitoni standat e atyre shkollave që ofrojnë programe që janë në interes të fëmijës. **Bëni pyetje** në lidhje me programin që ato ofrojnë dhe kërkesat e aplikimit. Nëse ka kërkesa të veçanta për pranim si psh. prova dëgjimi, intervista, ese, ose paraqitja e një dosje me punët më të mira (*portfolio*), kontaktoni këshilltarin psikolog të shkollës për ndihmë. Mësoni se si mund të jepni ndihmën tuaj në shtëpi.
- Kërkoni një takim me ekipin e IEP^{-së}, nëse është e nevojshme, për të folur mbi përparimin e fëmijës suaj në mësim dhe sjellje, mbi programet dhe proçesin e seleksionimit në shkollën e mesme dhe nëse ndonjë program ka përjashtime në kërkesat e pranimit dhe fëmija juaj mund të plotësojë këto kërkesa. Ekipi i IEP do të përcaktojë, nëse fëmija juaj mund të marrë pjesë me sukses në programet që ata dëshirojnë të aplikojnë, bazuar në mbështetjet dhe shërbimet e cilësuar në IEP^{-të} e tyre.